



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK GJIROKASTËR



Nr. 266 Prot

Gjirokastrë, më 20/5/2025

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJEREZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

TIRANË

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin për procedure paralele mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; *Udhëzimi Nr.759, datë, 30.09.2024 "Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë, Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Përbërjen e Njesisë së Zhvillimit të Institucioneve, Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe zhvillimit të vazhduar Profesional të Personelit"*. Ofruesi publik i AFP-së Qendra e Formimit Profesional Publik, Gjirokastrë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Administrimit të Formimit Profesional.

- Pozicioni

- a) Përgjegjës në Sektorin e Administrimit të Formimit Profesional. - 1 person (Gjirokastrë)



D) Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të forms së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit ;

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të studimeve Universitare të nivelit arsimor Master i shkencave (ose të barasvlefshme) në një nga fushat që lidhen me kualifikimet profesionale në lidhje me ofruesit publik të AFP-së
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në një ofrues publik të AFP-së
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certificate ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 29.05.2025,

DREJTOR

Mihare LAPA

